



## Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

### Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integrimi Evropiane**

*Mitrovicë, 16.04.2024*

## **FTESË PUBLIKE PËR TRAJNIM DHE PRAKTIKË NË PUNË ME PAGESË PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA.**

*Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integrimi Evropiane* duke u bazuar në Rregulloren Komunale NR – 08/2023 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve, i fton personat me aftësi të kufizuara të grup moshës 18-40 vjeç të aplikojnë për skemën trajnim dhe praktikë në punë në Biznese, OJQ dhe Institucione Publike.

Kohëzgjatja e trajnimit dhe praktikës në punë do të jetë 6 (gjashtë) muaj, jo më shumë se 20 (njëzet) orë në javë, dhe e njëjta ofrohet në bazë të Planit të Drejtorisë.

Të përzgjedhurit për trajnim dhe punë praktike me pagesë do të marrin një kompensim në formë të ndihmës financiare prej 220.00€, e cila pagesë bëhet me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të trajnimit apo praktikës, i cili kompensim bëhet në xhironlogarinë e përfuturit.

### **Dokumentet e nevojshme për Aplikim:**

- Aplikacioni - (Formularin e aplikimit mund ta merrni në zyrën e bizneseve apo në formë elektronike në web faqen e Komunës së Mitrovicës)
- I papunësuar duhet të jetë i regjistruar si punë kërkues të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit pas diplomimit - (Vërtetimi nga zyra e punësimit)
- Dëshminë që është banor rezident i Komunës së Mitrovicës së Jugut - (Letërnjoftimi dhe certifikata e vendbanimit)
- Dëshminë mbi përfundimin e shkollimit të mesëm apo të lartë - (Diplomën e shkollë së mesme te ulët/lartë apo fakultetit)
- Dëshmi mbi aftësinë e kufizuar - (vërtetim/vendim)

- Lista e punëkërkuësve merret në Institucionin përkatës për verifikim

I papunësuar i regjistruar nuk mund të jetë përfitues i punës praktike me pagesë më shumë se 1 (një) herë brenda 3 (tre) viteve.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën **07.05.2024**.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në adresën e mëposhtme:

**Komuna e Mitrovicës**

**Kati i parë, zyra pritëse**

**Rruga "Bedri Gjinaj", 40,000 Mitrovicë**

Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni Vlerësues

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen në zyrën e bizneseve në Komunën e Mitrovicës.

Elvis FEKA

Drejtore për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm

dhe Integritet Evropian

